



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:111051

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05602532

KF.nr.968/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Gashi Autosallon” SH.P.K., me seli në Ferizaj të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.p.k me seli në Prishtinë, Avalla P+12, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti Depo Doganore, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, G.B., dhe të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur, K.Sh., me datë 16.04.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Gashi Autosallon” SH.P.K. me seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET aktvendimi i të paditurës, Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.01.3.2.2/19546 i datës 23.09.2022.
- III. MBETËT në fuqi autorizimi për magazinim doganor me numër Reference WH397 për importin e mallrave nën regjimin pezullues IM7 për subjektin juridik “Gashi Autosallon” SH.P.K. numër unik identifikues 811502633.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 14.10.2022, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit

kontestues nr.01.3.2.2/19546 të datës 23.09.2022 për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të Kodit Doganor. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e paditësit ka deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë kërkesë padisë dhe pranë të gjitha pretendimeve të cekura në të, vendimi i kontestuar i të paditurës, konsiderojmë se është jo ligjor i marrë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale. Ky konflikt administrativ ka të bëjë edhe me vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit 04.1.5/16917 të datës 09.08.2022, i sektorit të autorizimeve, me të cilën ky sektor ka pezulluar autorizimin me nr.WH397, sipas këtij aktvendimi ky sektor ka arsyetuar se subjekti këtu paditësi ka shkaktuar kundërvajtje doganore sipas nenit 276 (pika h) dhe nga arsyetimi i këtij aktvendimi thuhet se pezullimi i autorizimit është bërë nën dyshimin e bazuar se pala nuk i është përmbajtur kushteve të autorizimit, ndërkohë se nuk është cekur fare se cilat janë ato kushte të autorizimit të cilave nuk i është përmbajtur paditësi e të cilat janë të cekura në autorizimin në fjalë. Më pas, pas kërkesës së paditësit për rishqyrtimin e këtij aktvendimi sektori për rishqyrtim ka arsyetuar se vendimi për pezullimin e autorizimit është i drejtë dhe se është vepruar drejtë komform nenit 15 parg.2 i KDA-së, pasi që kemi të bëjmë me një person jo të besueshëm sipas të paditurës. Së pari theksojmë se në këtë dispozitë ligjore nuk ceket fakti se pezullimi i autorizimit mund të bëhet për shkak të humbjes së besimit. Aplikimi i kësaj dispozite do të ishte i drejtë në rast se do të ishte vërtetuar fakti se paditësi nuk i është përmbajtur kushteve të autorizimit. Pezullimi i autorizimit për shkak të kundërvajtjes doganore e cila është iniciuar sipas vendimit 03.1.7-2022-1035/01.08.2021, është një procedurë në vete e cila nuk ka të bëjë me mos përmbushjen e kushteve të autorizimit e cila është pezulluar nga e paditura. I propozojmë gjykatës që të veproj sipas kërkesë padisë së paditësit dhe ashtu që të shtohet dhe fakti se pas aprovimit dhe anulimit të mbetet në fuqi autorizimi WH397. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 19.01.2024 ka deklaruar se: *aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka mbështetur me prova materiale.* Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e të paditurit ka deklaruar se: Kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, me arsyetimin se autorizimit nr.WH397, për importin e mallrave nën regjimin pezullues IM7, është marrë në vështrim të nenit 15 parg 2 të KDA-së, për arsye se paditësi në mënyrë të vazhduar nuk ka paraqitur saktë kilometrat, pra ka manipuluar me

kilometrat për deklaratën 6127/06/04.2022 ka shkarkuar me 19174/28.07.2022, paditësi ka deklaruar kilometra më të vogla ndërsa gjendja faktike ka qenë me kilometra më shumë, ky konstatim ka ardhur pas verifikimit në qendrën e homologimit. Andaj, në këtë rast paditësi është person jo i besueshëm për doganën për t'ia dhënë mundësinë që i njëjti të jetë bartës i autorizimeve për importin e mallrave nën regjimin pezullues IM7. Dispozitat ligjore që parashohin kushtet e veçanta shtesë që rregullojnë procedurën e shfrytëzimit të cilës do procedurë me ndikim ekonomik, kushtëzohet me lëshimin e autorizimit në referim të nenit 90, duke mos rënë ndesh me kushtet e veçanta shtesë që rregullojnë procedurën përkatëse, autorizimi i përmendur në nenin 89 dhe 105 paragraf 1 të KDA-së, citohet se: “ autorizimi jepet vetëm për persona që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zbatimin e drejtë të proceduarve” pra paditësi nuk është person i besuar, pasi që i njëjti ka manipuluar me kilometra në veturë. Andaj konsiderojmë se vendimi është i bazuar në dispozita ligjore. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat relevante dhe atë: Aktvendimi 19546/23 i datës 23.09.2022, aktvendimi 16917 i datës 08.08.2022, autorizimi për drejtim të një depoje doganore nr.WH397, DUD-i 19174/28.07.2022, 6127/06.04.2022, 18016/12.08.2022, 10645/03.06.2022, 979/24.01.2022, 763/20.01.2022, 6915/18.04.2022, 18566/21.07.2022, 5564/31.03.2022, 3985/09.03.2022, 30615/21.10.2021, kontrata e datës 01.04.2022, fotografi e panelit të instrumenteve të veturës, planet e pagesave të kësteve të kredisë në bankën ekonomike, përgjigja në padi e datës 19.01.2024, ankesa e ushtruar në doganë e datës 16.09.2022, aktvendimi 2022-1035/01.08.2022 dhe parashtresa e doganës e datës 08.08.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se e paditura me aktvendimin

04.1.5/16917 i datës 09.08.2022, ka revokuar autorizimin numër WH397 për importin e mallrave nën regjimin pezullues IM7, subjektin në procedurë këtu paditësit “Gashi Autosallon” – Ferizaj, me NUI:811502633, i autorizuar për procedurën e magazinimit doganor me numër reference WH397 deri në një vendim tjetër, si dhe e ka obliguar të njëjtin që mallrave nën procedurën e regjimit pezullues IM7 ti jepet trajtim i lejuar doganor deri me afatin e maturimit të garancionit të taksave me pezullim, në të kundërtën do të inkasohet garancioni i deponuar pranë Sektorit të Procedurave dhe Autorizimeve. Po ashtu nuk është kontestsues as fakti se subjekti në procedurë këtu paditësi, kundër aktvendimit të lartcekur ka ushtruar ankesë pranë Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës së Kosovës, e cila me datën 23.09.2022 ka sjell Aktvendimin nr.19546, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e ndaj të cilit akt paditësi me padinë e datës 14.10.2022, ka iniciuar në gjykatë këtë kontest tregtar - administrativ.

Kontestuese në këtë kontest tregtar administrativ mbetet vetëm ligjshmëria e vendimit të kontestuar me padi, respektivisht shfrytëzimi i procedurës me ndikim ekonomik nga këtu paditësi sipas Autorizimit WH397 për depo doganore të tipit D, e që nënkupton vetëm regjimin doganor me taksa të pezulluar nën kushtet e përcaktuara me autorizim.

E paditura Dogana e Kosovës me aktvendimin e kontestuar ka konstatuar se Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve ka vepruar drejtë kur ka revokuar autorizimin numër WH397 për importimin e mallrave nën regjimin pezullues IM7 për subjektin në procedurë, dhe ka obliguar subjektin që mallrave nën procedurën e regjimit pezullues në IM7, ti jepet trajtim i lejuar doganor deri në afatin e maturimit të garancioneve të taksave me pezullim, në të kundërtën do të inkasohen garancionet bankare të deponuara pranë SPA në vështrim të nenit 15 paragrafi 2 të KDA-së, për arsye se subjekti në procedurë është person që ka shkaktuar kundërvajtje doganore. Tutje ka theksuar se i njëjti ka shkarkuar deklaratë unike doganore IM7 R-6127/06.04.2022 shkarkuar me DUD-in R-19174/28.07.2022, pas verifikimit në Qendrën e Homologimit (QAK) të kilometrave konstatohet se për importet e lartcekura gjendja e kilometrave nuk është reale, pra subjekti ka deklaruar kilometra më të vogla ndërsa gjendja faktike ka qenë me kilometra më shumë. Në bazë të dhënave Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve revokon autorizimin për depo doganore WH397 në vështrim të nenit 15 par.2 dhe nenit 90 par.1 të KDA-së, andaj, bazuar në këto dispozita si dhe protokollit nr.04.1.5/16917/08.08.2022 për kriteret e autorizimit për depo doganore tipi D, subjekti në procedurë nuk ofron garancitë e nevojshme lidhur me shfrytëzimin e mëtutjeshëm të autorizimit për magazinim doganor.

Gjykata në këtë fazë e konsideron si të padrejtë konstatimin e Sektorit të Procedurave dhe të Autorizimeve pranë të paditurës se subjekti ankimor nuk është person i besuar pasi që i njëjti ka përdorur dokumente të dyfishta me qëllim të përfitimit material, dhe se me veprimet e kryera ka bërë shkelje të nenit 276 pika k) të KDA-së, kjo për faktin se procedura kundërvajtëse është vetëm e iniciuar dhe se e njëjta nuk ka marrë epilog, pra nuk kemi vendim të formës së prerë lidhur me ekzistimin ose jo të procedurës kundërvajtëse, për më tepër Gjykata vlerëson se në këtë rast objekt shqyrtimi nga e paditura do të duhet të ishte përmbushja ose jo e kushteve të autorizimit, dhe eventualisht ndonjë shkelje referuar këtyre kushteve dhe jo inicimi i një rasti kundërvajtës dhe atë në procedurë të zhdoganimit të mallit.

Nuk është kontestues fakti se Dogana e Kosovës bazuar në dispozitat e nenit 15, par 2, të Kodit Doganor dhe të Akcizave, Kodi nr. 03/L-109, e ka mundësinë e revokimit të autorizimit dhe atë në rastet kur personi të cilit i është adresuar dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga vendimi në fjalë, por se askund në këtë dispozitë nuk theksohet thirrja “humbje e besimit”, ashtu siç ka theksuar e paditura se (subjekti ankimor nuk është person i besuar), mirëpo për tu arritur ky kusht sipas nenit 15.2 i Kodit si më lartë duhet që gjithsesi të kemi një konstatim faktik nga e paditura referuar mos plotësimit, ose mos përmbushjes, ose shkeljes së kushteve të përcaktuara me Autorizimin WH397 e që kanë të bëjnë me vendin ku mbahen të dhënat, me llojin e të dhënave, me mallrat që duhet të vendosen nën mbikëqyrje doganore, me kod tarifor, përshkrim dhe vlerë të taksave të pezulluara, me zyrat doganore të hyrjes dhe të shkarkimit IM4 dhe EX3, me zyrën mbikëqyrëse, me aplikimin e procedurave në import me regjim IM7, me aplikimin e procedurës së lirimit në qarkullim të lirë IM4 nga regjimi IM7, me aplikimin e procedurës së Ri-eksportit EX3 nga Regjimi IM7, dhe të procedurës së transferit, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet konstatimi i saktë i gjendjes faktike e me këtë edhe zbatimi i duhur i të drejtës materiale, në të kundërtën thirrja nga Dogana e Kosovës në humbje të besimit, dhe veprimi drejt revokimit të autorizimit të tipit “D”, bazuar vetëm në inicimin e një rasti në kundërvajtje pa ndonjë vendim përfundimtar, përveç që do të cenonte rëndë nenin 15, par 2, lidhur me nenin 90 të KDA-së, do të humbte edhe vetë kuptimin e aranzhimeve sipas procedurave me ndikim ekonomik siç janë të sqaruara në UA 11/2009, respektivisht në kreun III të këtij Udhëzimi.

Nga interpretimi i dispozitës ligjore të nenit 15, par. 2, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se e paditura ka pasur të drejtë ta revokoj autorizimin e dhënë këtu paditësit vetëm atëherë kur i njëjti dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga vendimi-autorizimi në fjalë, pra kjo normë ka kuptimin e tillë që njëherë jepet Autorizimi për depo

doganore të tipit D, gjithmonë bazuar në kërkesë dhe atë sipas kushteve të përcaktuara me nenet 103 deri 117 të KDA-së, lidhur me nenet 300 deri 310 të UA 11/2009, dhe vetëm atëherë nëse personi të cilin i është dhënë ky autorizim dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga i njëjti, Dogana mund të marr veprime drejtë revokimit të të njëjtit, dhe jo sikurse në rastin konkret kur vet e paditura nuk ka konstatuar asnjë fakt që lidhet me dështim në përmbushje të kushteve sipas autorizimit WH397 nga këtu paditësi.

Gjykata ka analizuar edhe nenin 90 par 1. të KDA-së ku thuhet se: *Pa rënë ndesh me kushtet e veçanta shtesë që rregullojnë procedurën përkatëse, autorizimi i përmendur në nenin 89 dhe ai në nenin 105 (1) do të jepet vetëm: - për personat që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zbatimin e drejtë të procedurave, dhe se kjo e forcon bindjen edhe më tutje se elementi konstituiv i kësaj norme konsiston prapë se prapë në vlerësimin e asaj se në rastin konkret a kemi përmbushje ose jo të kushteve sipas autorizimit WH397, gjë që nga e paditura kjo asnjëherë nuk është vë në dyshim, pra se këtu paditësi ka dështuar në përmbushjen e kushteve të specifikuar ne autorizim, për më tepër kjo dispozitë konsiston edhe në faktin se e paditura gjithmonë për vlerën e taksave të pezulluara sipas autorizimit përkatës kërkon garancion bankar dhe doganor, si parakusht për dhënie të autorizimit.*

Gjykata nga neni 105, par 2. I KDA-së ku thuhet se: *“Çdo person që dëshiron të administrojë me magazinë doganore, duhet të bëjë një kërkesë me shkrim, e cila përmban të dhëna të nevojshme për lëshimin e autorizimit, duke demonstruar se ekziston një nevojë ekonomike për magazinë. Në autorizim përcaktohen kushtet për administrimin e magazinës doganore”,* ka konstatuar se magazinë apo depo doganore e tipit D, për një subjekt juridik ka vetëm efekt ekonomik financiar, siç janë taksat e pezulluara nga momenti i importit me IM7 e deri në momentin e lëshimit të tyre në qarkullim të lirë me IM4, por se në asnjë rast ky autorizim nuk nënkupton mos zbatim të mbikëqyrjes doganore, përkundrazi malli që futet në procedurë nën regjimin pezullues IM7, përveç që kalon përmes procedurës së rregullt gjatë fazën së procedimit të IM7, e që nënkupton të gjitha formalitetet doganore të përcaktuara sipas profilizimit të riskut të aplikuar nga Dogana njëjtë sikurse edhe në rastet e realizuara të Importeve me IM4 nga ky subjekt, vetëm se këto mallra që janë futur me IM7 mbesin nën mbikëqyrje doganore përderisa të njëjtat nuk shkarkohen qoftë me deklaratë IM4 apo EX3, çka për Doganën paraqet filtër të dyfishtë në kuptim të ushtrimit të mbikëqyrjes doganore në këto raste, ashtu siç përmendet edhe në nenin 103, par 2. Të KDA-së ku thuhet se: *Me magazinë doganore nënkuptohet çdo vend i*

aprovuar, i cili është nën mbikëqyrje nga Dogana, ku mallrat mund të strehohen sipas kushteve të parapara.

Tutje gjykata nga neni 106, i KDA-së e ku shprehimisht është përcaktuar se: *Administruesi i magazinës është përgjegjës për: a) Të siguroar që mallrat, gjatë kohës sa janë në magazinën doganore të mos i shmangen mbikëqyrjes doganore; b) T'i plotësojë obligimet që lindin nga magazinimi i mallrave që ndodhen nën regjimin e magazinimit doganor dhe c) Të respektojë të gjitha kushtet e specifikuara në autorizim, ka gjetur se e paditura në vendimin e saj nuk ka theksuar asnjë nga dispozitat si më lartë, në kuptim të asaj se njëra ose dy nga to ose të gjitha së bashku janë shkelur nga bartësi i autorizimit WH397, për të mundur të vlerësohet përgjegjësia e bartësit të autorizimit në raport me mundësinë eventuale të revokimit të autorizimit.*

Gjykata ka elaboruar edhe tërë bazën ligjore që i referohet aranzhimeve doganore sipas regjimeve pezulluese dhe ka gjetur se për të paditurën autorizimi për depo doganor i tipit D, në kuptim të procedurave doganore dhe realizimit të mbikëqyrjes doganore nuk ka asnjë efekt negativ, përkundrazi rastet sikurse ky i paditësit për Doganën nënkuptojnë filtër të dyfishtë në kuptim të ushtrimit të mbikëqyrjes doganore, një me rastin e procedimit të deklaratës doganore IM7, e cila deklaratë varësisht nga profili i përcaktuar sipas sektorit të analizës së rrezikut pranë të paditurës, kalon në kanalet e ekzaminimit në Doganë sikurse çdo deklaratë tjetër IM4, vetëm se në këtë rast për dallim nga deklaratat IM4, kur malli menjëherë pas përfundimit të procedurave doganore del në qarkullim të lirë e më këtë edhe del nga mbikëqyrja doganore, malli që futet në IM7 edhe më tutje mbetet nën mbikëqyrje doganore dhe Dogana në çdo kohë ka qasje në këto dërgesa dhe mund të ushtroj kontrolle shtesë.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi dhe atyre në seancë gjyqësore, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Pala paditëse, konstatimet siç u theksuan edhe më lartë i ka bazuar në dokumente të besueshme të cilat janë administruar si prova nga gjykata dhe të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj as e paditura me ndonjë provë materiale.

Ligji Nr. 03/L-202, për konfliktet administrative, Neni 44 1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”,* paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”.* Paragrafi

3. “Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”, tutje gjykata duke qene e lidhur me qëndrimin brenda kufijve të padisë dhe meqë nuk ka pasur kërkesa të tjera siç kërkohet me dispozitën në vijim, paragrafi 5. i këtij ligji *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, kjo edhe pasi që ka konstatuar se ka shkelje të ligjit në dëm të këtu paditësit andaj edhe doemos u desh që ky aktvendim të anulohet.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, lidhur me nenin 44, par 1, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.968/22, datë 16.02.2024

Zyrtare ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.